

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda—në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Vehbi Kashtanjeva- kryetar i trupit gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Ferinaze Jashari, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.M., për shkak të veprës penale në tentativë Transportimit i paautorizuar i armëve nga neni 372 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Prishtine, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.1129/2013, të datës 08.09.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbal e publik në prezencë të prokurores së shtetit Besa Limani, të akuzuarit F.M., me datë 03.09.2018, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.M., nga i ati I. dhe nënës S.1, e gjinisë S.2, i lindur më ... në B. të Z., me vendbanim të përhershëm në rrugën "I.Gj." H..., K... banesa ... P., me numër të pasaportës së lëshuar nga shteti i Z. ..., si dhe karta e identitetit ..., realizon të ardhura mujore në shumën prej ... f. z., i gjendjes se mesme ekonomike, i martuar baba i një fëmije, punëtorë i ndërtimtarisë, ka të kryer shkollën e mesme shqiptar, shtetas i Z., ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

I akuzuarit F.M. në shkelje me Ligjin për armët ka mbajtur në pronësi një elektroskok tip 1101 Flachlight, në formë baterie për ndriçim, ngjyrë e zezë, modeli Police, me kapacitet 8.000 Ë, prodhim gjerman, në atë mënyrë që me dt. 02. 11. 2013 në valigjen e tij gjatë kontrollit në Aeroportin e Prishtinës "A.J. " i është gjetur dhe konfiskuar me rastin e nisjes së tij për në Z..

-Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronsi kontroll posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 2,3,4,41,42,49,50,51,69,73,74,75,76 të KPRK-së dhe nenit 359, 365, 450 të KPPRK-së e :

GJYKON

ME DËNIM ME BURGIM - DËNIM ME KUSHT në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogaris përfundimtare të Gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga **100 (njëqind) euro**, në afat prej **15 ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, si dhe të paguaj shumën prej nga **50(pesëdhjetë) euro**, në emër taksën për kompensimin e viktimave në bazë të nenit 39 Ligji nr. 05/L për kompensimin e viktimave të krimit.

Të akuzuarit i konfiskohet arma elektroskok tip 1101 Flachlight, në formë baterie për ndriçim, ngjyrë e zezë, modeli Police, me kapacitet 8.000 Ë, prodhim gjerman,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Renda ka ngritur aktakuzën PP.nr. 1129/2013, të datës 08.09.2014, kundër të akuzuarit F.M., për shkak të veprës penale në tentativë Transportimit i paautorizuar i armëve nga neni 372 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPK-së,

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datën 03.09.2018, në të cilën prokurorja e shtetit Besa Limani, ka bërë ri cilësimin e veprës penale nga vepra penale nga neni 372 par. 1 të KPK-së lidhur me nenin 28 të KPK-së, për të cilën ngarkohet i akuzuari duhet të jetë vepra penale Mbajtja në pronsi kontroll posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 dhe dispozitivi duhet të jetë në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët ka mbajtur në pronësi një elektroskok tip 1101 Flachlight modeli Police.

I akuzuari F.M. në shqyrtimin fillestar pasi që është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për sçarim shtesë dhe pasi që i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, i njëjti deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronsi kontroll posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1.

Prokurori i shtetit, në shqyrtimin fillestar është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit duke vlerësuar se ai pranimin e ka bërë me vullnet të plotë duke qenë paraprakisht i njoftuar nga gjykata për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, po ashtu ky pranim është bërë në përputhshmëri edhe me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 248, par. 1, nen par.1.1,1.2,1.3,1.4 dhe par.4 i KPPK-së, se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari.

Me rastin e përcaktimit të dënimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit mori parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, sjelljet e mira gjatë seancës fillestare dhe pendimin e thellë të shprehur gjatë shqyrtimit fillestar. Për të akuzuarin gjykata nuk gjeti rrethana rënduese.

Gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe me aplikimin e dispozitave ligjore të përmendura në dispozitiv, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njëjti do të shërbejë si preventivë individuale dhe gjeneralë dhe parandalim se në të ardhmen nuk do të kryeje vepra penale, duke ndikuar në rehabilitimin e tij, me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit sikurse që parashihet me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata i mori në bazë të nenit 450 par.3 të KPPRK-së.

Nga sa u tha me lartë u vendos sikur ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 471/14 te dt. 03.09.2018**

**Procesmbajtësja:
Ferinaze Jashari**

**Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari:
Vehbi Kashtanjeva**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.